



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 1567/1 Prot

Tiranë, më 05.11.2019

**V E N D I M**

Nr.117, datë 05.11.2019

***“Mbi përfundimineinspektimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Sarandë, filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit,në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil,si dhe zbatimin e standardeve ligjore në përgatitjen e strukturës dhe organigramës të kësaj bashkie”.***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Sarandë,

**VËREJ SE,**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim vlerësimin e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65,(nr. 1453 prot), datë 12.09.2019,“Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht

procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Sarandë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Këshilli i Bashkisë Sarandë, me vendimin nr. 79, datë 29.12.2018, “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelin e pagave për vitin 2019, të Bashkisë dhe institucioneve në varësi”, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Sarandë dhe njësitëve administrative e institucioneve në varësi të saj. Në zbatim të këtij vendimi, kryetari i Bashkisë Sarandë, bazuar në nenin 64, shkronja “j”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, me Urdhërin nr. 09, datë 30.01.2019, “Struktura organike e Bashkisë Sarandë dhe funksionet e deleguara” ka miratuar strukturën analitike të kësaj njësie vendore. Kjo strukturë dhe organikë është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas kësaj strukture, Bashkia Sarandë së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **62** pozicione pune të vlerësuar si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **1** pozicion pune i kategorisë së lartë drejtuese, **8** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese dhe **53** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se **39** pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar sipas kërkesave ligjore apo nëpërmjet procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **17** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë të plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe josipas një procedure të rregullt konkurrimi, ndërsa **6** pozicione të shërbimit civil kanë rezultuar vende vakant.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. \*\*\*\*\* “Sekretar i Përgjithshëm”, aktualisht i emëruar me aktin nr. 84, dt. 14.08.2019. Nëpunësi me aktin nr. 143, datë 27.07.2011, është emëruar “Drejtor në Drejtorinë Juridike”, në Bashkinë Sarandë dhe është deklaruar nëpunës civil, me aktin 24 datë 13.06.2014, në pozicionin e mësipërm.
2. \*\*\*\*\* “Specialist Kontabiliteti” në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Financiar dhe Përkujdesjes Sociale, emëruar me aktin nr. 68, dt. 09.07.2019;

3. \*\*\*\*\* “*Specialist i Inspektimit në Terren*”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me aktin nr. 56, dt. 21.04.2017;
4. \*\*\*\*\* “*Specialist i Inspektimit në Terren*”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me aktin nr. 57, dt. 21.04.2017;
5. \*\*\*\*\* “*Specialist e Vlerës, Planifikimit të Ardhurave Inspektimit në Terren*”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me aktin nr.58, dt.17.06.2019;
6. \*\*\*\*\* “*Specialist TIK*” në Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore, emëruar me aktin nr. 82, dt.06.07.2017;
7. \*\*\*\*\* “*Specialist Projektimi dhe Infrastrukture*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me aktin nr.155, dt.02.10.2017;
8. \*\*\*\*\* “*Specialist i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit*” në Drejtorinë e Shërbimeve Publike emëruar me aktin nr. 61, dt. 23.11.2015;
9. \*\*\*\*\* “*Specialist për Zhvillimin Vendor dhe Bashkëpunimin*” në Drejtorinë e Programimit, Zhvillimit dhe Turizmit, emëruar me aktin nr. 127, dt.05.11.2018;
10. \*\*\*\*\* “*Drejtor i Auditit të Brendshëm*” në Drejtorinë e Programimit, Zhvillimit dhe Turizmit, emëruar me aktin nr. 88, datë 21.08.2019;
11. \*\*\*\*\* “*Specialist Auditi*” në Drejtorinë e Programimit, Zhvillimit dhe Turizmit, emëruar me aktin nr. 102, dt. 07.06.2017;
12. \*\*\*\*\* “*Specialist Auditi*” në Drejtorinë e Programimit, Zhvillimit dhe Turizmit, emëruar me aktin nr. 23/1, dt. 21.06.2019;
13. \*\*\*\*\* “*Specialist Jurist*” në Drejtorinë Juridike, emëruar me aktin nr.112, dt.21.09.2018;
14. \*\*\*\*\* “*Specialist Jurist*” në Drejtorinë Juridike, emëruar me aktin nr. 135, dt. 13.12.2018;
15. \*\*\*\*\* “*Specialist Jurist*” në Drejtorinë Juridike, emëruar me aktin nr.79, dt. 29.05.2017;

16. \*\*\*\*\* “*Specialist Jurist për IMT dhe Planifikimin dhe Kontrollin e Territorit*” në Drejtorinë Juridike, emëruar me aktin nr. 21/2, dt. 27.08.2019;
17. \*\*\*\*\* “*Specialist i Njësisë së Prokurimeve*”, në Drejtorinë Juridike, emëruar me aktin nr. 45, dt. 03.05.2010.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi.

*Cdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, në bazë të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, është absolutisht i pavlefshëm.*

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Sarandë, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart; të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhëniet e punës të lidhura në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji dhe më tej, të vazhdohet duke i shpallur të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me legjislacionin e nëpunësit civil.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të tregojë kujdespë të përmbushur rregullat e përcaktuara në kreun IV “*Pranimi në shërbim civil*”, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes*”

*paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.*

Duke u nisur nga rrethanat e evidentuara më sipër, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që të realizojë procedurat e rekrutimit në grup, në nivelin ekzekutiv, duke pasur në vëmendje pikën 8, të nenit 19, të ligjit për nëpunësin civil, e cila i klasifikon pozicionet e punës në grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit posaçëm.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **V E N D O S A:**

1. Për rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, Kryetari i Bashkisë Sarandë konstaton menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **17** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil të evidentuara nominalisht në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.
2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse që për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, të cilat në kuptim të ligjit janë vende vakante, të hartohen përshkrimet e punës sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të ndryshuar.
3. Njësia përgjegjësetë marrë masa të menjëhershme për fillimin e procesit të plotësimit të gjithë pozicioneve të përmendura në pjesën arsyetuese, si pozicione të zëna në mënyrë të kundraligjshme duke shpallur konkurrimet përkatëse, sipas kërkesave ligjore.
4. Institucioni tëpërgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në

vendimin nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

5. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të tregojë kujdes në zbatimin e ligjit për shërbimin civil, duke orientuar Kryetarin e Bashkisë për një strukturë efikase, në të cilën të evidentohen qartazi pozicionet e shërbimit civil, duke i ndarë nga pozicionet që kryejnë funksione politike apo që nuk ushtrojnë autoritet publik (*punonjësit administrativë*), dhe t’i përshtatë detyrat, funksionet dhe emërtesat e pozicioneve të shërbimit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 19, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; vendimit nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, si dhe me ligjet që rregullojnë çdo sektor të veprimtarisë së bashkisë.
6. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar, në mënyrë që të realizojë sa më saktë zbatimin e pikës së mësipërme të këtij vendimi.
7. Të përmbillet procesi i mbikëqyrjes i cili është materializuar me vendimin paralajmërues vendimin nr. 03, datë 08.02.2018, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Sarandë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt, sipas urdhërimeve të dispozitivit të këtij vendimi.
8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Sarandë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

9. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
10. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Sarandë, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Sarandë, Ministria e Brendshme, si dhe çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqim menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**